



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:063374
Datë: 12.12.2023
Numri i dokumentit: 05053037

PPP.nr. 381/19

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, si dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Festim Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit: Korporata Kosovare për Furnizim me Energjetike e Kosovës (KESCO), me adresë Bulevardi Bill Clinton Nr.5, Ndërtesa ElektroKosova, Kati II, Prishtinë 10,000, kundër debitorit G.C, me vendbanim në fshatin Ç. Komuna Prishtinë, në çështjen juridike përbarimore për borxh në shumën prej 284.01€, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përbarimit P.nr.645/2018, të datës 09.08.2018, të lejuar nga Përbaruesja Private Rrezarta Metaj në Prishtinë, jashtë seance, me datë 12.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET në tersi i bazuar prapësimi i debitorit G. C me vendbanim në fshatin Ç Komuna Prishtinë, ashtu që:
- II. SHFUQIZOHET urdhëri përbarimor P.nr.645/2018 i datës 09.08.2018 i nxjerrë nga përbaruesja private Rrezarta Metaj në Prishtinë, anulohen të gjitha veprimet e kryera deri në këtë fazë të procedurës si dhe përfundohet procedura përbarimore e iniciuar sipas urdhrit përbarimor P.nr.645/2018 i datës 09.08.2018.

Arsyetim

Zyra përbarimore - Përbaruesja Private Rrezarta Metaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër në bazë të dokumentit të besueshëm - ekstraktit nga librat afarist DRP-90076174 në emër të G. C , ashtu që ka lejuar propozimin për përbarim dhe ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhëri, t'ia paguaj kreditorit shumën në vlerë prej 284.01€, me kamatë prej 8% duke llogaritur nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore aq sa do të krijohen sipas tarifës së përbaruesve privat nën kërcënim e ekzekutimit të dhunshëm, me ndalim të mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e kreditorit, si dhe regjistrimin,

sekuestrimit, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të cilat ndodhën në posedim të debitorit deri në vlerën e borxhit.

Kundër urdhrit për lejim të përmbarimit debitori G. C, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim. Në prapësim debitori ka theksuar se gjatë vitit 2018 ka qenë shumë i rregullt me pagesat e energjisë elektrike dhe asnjëherë nuk ka pranuar vërejtje me shkrim se borxhi nuk është paguar me rregull. Ka shtuar se kreditori ka iniciuar procedurë përmbarimore mirëpo me datë 28.02.2018 i ka paguar shumën prej 100.00€ në emër të energjisë elektrike, ndërsa me datë 29.11.2018 ka paguar shumën prej 150€ dhe të njëjtat janë paguar pa qenë fare për propozimin për përmbarim të iniciuar nga kreditori. Mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të aprovohet.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim ku lidhur me pretendimet e debitorit ka theksuar se e kundërshton në tërsi prapësimin si të pabazuar dhe të paargumentuar. Ka shtuar se propozimi për përmbarim është bërë për periudhën 25.12.2017 deri me datë 07.07.2018 duke e bashkangjitur edhe ekstraktin nga librat afarist ku tek kriteri minimal është precizuar borxhi kumulativ, e jo i ndarë nga faturë për faturë mujore dhe në këtë transaksion të konsumatorit asnjëherë nuk ka pas ankesa të parashtruara për kontestim të borxhit për muajt për të cilët është bërë propozimi për përmbarim. Gjithashtu ka theksuar se kreditori në propozim për përmbarim ka bërë precizimin e kërkesës për periudhën kohore prej 25.12.2017 deri me datë 07.07.2018 në shumë 284.01€ duke bashkangjitur edhe faturat për Dhjetor 2017 dhe Janar, Shkurt, Mars, Maj, Qershor, Korrik 2018. Mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që urdhëri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të paraqitur nga kreditori, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi nuk është i bazuar, nga këto arsye:

Nga analizimi i propozimit për përmbarim, gjykata gjeti se kreditori me datë 08.08.2018 pranë zyrës së përmbarueses private ka parashtruar propozim për përmbarim kundër debitorit mbi bazën e dokumentit të besueshëm - ekstraktit nga librat afarist DPR-90076174 në emër të G. C. Ndërsa borxhi në shumë prej 284.01€ kërkohet për periudhën 25.12.2017 deri me datë 07.07.2018.

Nga analizimi i ekstraktit nga librat afarist DPR-90076174 në emër të debitorit G. C, gjykata gjeti se për periudhën 25.12.2017 deri me datë 07.07.2018 në emër të shpenzimit të energjisë elektrike, nga kreditori është faturuar në shumën prej 288.70€. Ndërsa brenda kësaj periudhe, në emër të pagesave për shpenzimin e energjisë elektrike debitori ka realizuar pagesa dhe atë me datë 04.01.2018 shumën 95.00€, me datë 21.05.2018 shumën 150.00 €, me datë 25.05.2018 shumën 30.00€, si dhe me datë 26.06.2018 shumën 120.00€, gjithsej shumën prej 395.00€. Nën këto rrethana rezulton se debitori për periudhën kohore nga data 25.12.2017 deri me datë 07.07.2018, nuk ka borxh të papaguar madje në rastin konkret kemi mbipagesë në shumë prej 106.30€.

Në momentin e vendosjes, gjykata shqyrtoi edhe pretendimin e kreditorit se borxhi i kërkuar është precizuar si borxh kumulativ e jo i ndarë nga faturë për faturë mujore, mirëpo për deri sa vet kreditori ka specifikuar se objekt shqyrtimi i kësaj lënde është borxhi në emër të shpenzimit të energjisë elektrike vetëm për periudhën kohore nga data 25.12.2017 deri me datë 07.07.2018, gjykata gjeti se për këtë periudhë debitori nuk i ka borxh kreditorit.

Gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për paraqitje të prapësimit në bazë të nenit 71 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore ku si shkak për paraqitje të prapësimit parashihet kur: “ *dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë* ”e që në rastin e kësaj lënde përmbartimore gjykata vlerëson se dokumenti i besueshëm - Ekstrakti nga librat afarist PR-90076174 në emër të debitorit G. C, mbi bazën e të cilit është iniciuar kjo procedurë përmbartimore, nuk i përmban tiparet e përmbartueshmërisë konform nenit 29 paragrafi 3 i Ligjit të Procedurës Përmbartimore për arsye se nga përlllogaritja e faturimeve të kreditorit dhe pagesat e kryerja nga debitori, rezulton se shuma prej 284.01€ e kërkuar nga kreditori nuk ekziston në periudhën kohore 25.12.2017 deri me datë 07.07.2018, për më tepër për këtë periudhë debitori ka mbipagesë në shumë prej 106.30€.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj te njëjti vendosi që ta aprovoj në tërsi në bazë të nenit 73 paragrafi 3 i Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Ndërsa vendosjen për anulim të veprimeve dhe përfundim të procedurës përmbartimore si në pikën II të dispozitivit, gjykata e mbështet në nenin 73 paragrafi 4 sipas Ligjit Nr.05/L-118 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.381/2019, dt.12.12.2023

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.